



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 18 datë 04.06.2024

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PROJEKTIT GJATË NDËRTIMIT PËR
OBJEKTIN: "STRUKTURA HOTELERIE DHE REZIDENCA TURISTIKE, 1, 2, 3, 4,
5 KATE ME 1, 2 KATE NËNTOKË", ME VENDNDODHJE NË JALË, BASHKIA
HIMARË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Jala Investment" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të projektit gjatë ndërtimit për objektin: "Struktura hotelerie dhe rezidenca turistike, 1, 2, 3, 4, 5 kate me 1, 2 kate nëntokë", me vendndodhje në Jalë, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Jala Investment" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhur Vendimit Nr. 15 datë 10.06.2021, zëvendësohen me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 23.06 / 2025